



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2015
Nr. Dok. 201501302/23

Lënda : *Rekomandim për shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër të datës 14.09.2015 për mosfillimin e procedimit penal.*

Drejtuar : Prokurorit të Përgjithshëm
Z. Adriatik LLALLA

Tiranë

I nderuar zoti Llalla,

Në institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetësja Sh. Gj., e cila ndërmjet të tjerave shkruan se, në datën 05.07.2015, rreth orës 12:30, djali i saj M.Gj., duke qënë në banesë në fshatin Guci e Re Shkodër, është dhunuar fizikisht në mënyrë çnjerëzore nga forca të shumta policie me uniforma të zeza dhe me kapuçë në kokë dhe disa civilë. Sipas ankueses, këto forca kanë qënë në një aksion policor për kapjen e autorit të vrasjes së dy turistëve çek. Djali i saj, M.Gj., ka qënë në banesë së bashku me gjyshen dhe vëllanë e mitur. Forcat e policisë i kanë rënë derës së oborrit dhe M. ka shkuar që të hapë derën, por punonjësit e policisë pa bërë asnjë komunikim me të e kanë shtrirë në tokë dhe e kanë goditur me qytë automatiku dhe sende të forta, duke i shkaktuar plagë dhe shëmbje në pjesë të ndryshme të trupit. Sipas saj, gjatë kohës që forcat e policisë ushtronin dhunë ndaj tij, ai nuk ka bërë asnjë lloj rezistence ndaj tyre dhe se dhuna ndaj tij ka ndaluar kur forcat e policisë morën informacion se autori i vrasjes së shtetasve çek ishte kapur në një vend tjetër, në fshatin Grudë e Re.

Nga punonjësi i institucionit tonë në datën 13.07.2015 u morrë takim me shtetasin M.Gj., i cili ndodhej i paraburgosur në IEVP Shënkoll, Lezhë. Nga pyetja e tij me procesverbal, ndërmjet të tjerave ai deklaroi se, në datën 05.07.2015, rreth orës 12:30 - 13:00, duke qënë në banesë në fshatin Guci e Re, Shkodër, dëgjoi thirrjet e policisë. Pas kësaj, ai shkoi që të hapte portën e oborrit, por prej tyre është urdhëruar që të shtrihej në tokë dhe të mos lëvizte se do ta vrisnin. Pasi ata e kanë lidhur me pranga e kanë dhunuar atë fizikisht për rreth 30 minuta. Sipas M., ai është goditur prej tyre me grushta, shkelma, qytat e automatikëve, dorezat e pistoletave, bisht sopate, si dhe është tërhequr zvarrë për disa metra deri tek dera e banesës. Gjithashtu ai pretendon se,

punonjësit e policisë gjatë ushtrimit të dhunës e kanë fyer rëndë atë. Për shkak të goditjeve të shumta dhe të forta, atij i janë shkaktuar dhimbje, plagë dhe hemoragji në pjesën e fytyrës dhe në gjoks. Ai pretendon se, personi kryesor që ka ushtruar dhunë ndaj tij ka qënë Zëvendës drejtori i Policisë së Qarkut Shkodër Avni Canameti, të cilin ai e ka identifikuar nga një fotografi që ia kanë sjellë familjarët e tij në paraburgim.

Meqënëse nga punonjësi i institucionit tonë gjatë takimit të bërë me shtetasin M.Gj. u konstatuan shenja dhunë në fytyrën dhe në trupin e tij, me shkresën e datës 14.07.2015 i kërkuam mjekut ligjor pranë Spitalit Rajonal Lezhë kryerjen e ekspertimit mjekoligjor të tij. Mjeku ligjor Petrit Luli në datën 15.07.2015 është paraqitur pranë IEVP Shënkoll për të bërë ezaminimin e shtetasit M.Gj., por është penguar nga drejtuesit e këtij institucioni. Megjithatë mjeku ligjor në datën 23.07.2015 ka shkuar përsëri në IEVP Shënkoll dhe ka bërë ezaminimin e ankuesit.

Në vijim të hetimit administrativ të këtij rasti, nga punonjësit e institucionit tonë u pyetën me procesverbal shtetasit Gj.Gj., M.Gj., Xh.Gj., M.M., M.M. dhe L.Rr.. Gjithashtu u pyetën edhe punonjësit e policisë, efektiv të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Shkodër, si zëvendës drejtori shtetasi Avni Canameti, i cili është një nga personat që ankuesi pretendon se e ka keqtrajtuar fizikisht, si dhe disa nga punonjësit e policisë që kishin marrë pjesë në veprimet e kryera në banesën e shtetasit M.Gj. në datën 05.07.2015, si Shefi i Komisarariatit të Policisë Shkodër Gazmend Demrozi, agjenti i policisë kriminale Arvit Salihi, specialisti i policisë së zonës Ylli Dardha, patrulla e policisë Gjergj Ashta dhe punonjësi i policisë rrugore Bahri Laçaj.

Sipas punonjësve të policisë, në banesën e shtetasit Gj.Gj. kanë qënë rreth 200 punonjës policie të forcave speciale FNSH dhe RENEA-s dhe të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Shkodër. Forcat e policisë kanë shkuar në këtë banesë sepse kishin marrë një informacion nga banorët e zonës, se autori i vrasjes se dy turistëve cek ishte fshehur në banesën e tij. Ata deklaruan se kanë shkuar në këtë banesë dhe kanë trokitur e thirrur për të hapur portën e havllisë, por megjithë thirrjet e shumta dhe me megafon porta nuk është hapur. Ndodhur në këto rrethana disa punonjës të forcave speciale kanë hyrë në oborr nga havllia dhe kanë mundur të hapnin portën. Personi që ka dalë nga shtëpia, shtetasi M.Gj., ka kundërshtuar urdhrin e policisë për të hapur portën dhe thirrjet e saj nëse kishte në banesë autorin e kërkuar. Ndodhur në këto kushte, M. është urdhëruar nga forcat RENEA që të shtrihet në tokë dhe vinte duart prapa. Në prezencë të tij është bërë kontrolli i banesës dhe i disa ambienteve të tjera dhe nga kontrolli nuk është gjetur autori i kërkuar, por janë gjetur sende të ndaluara, si 1 automatik kallashnikov dhe disa krehëra me fishek, 1 çifte pa leje dhe një sasi lënde e dyshuar si narkotike. Për këtë shkak ai është arrestuar në kushtet e flagrancës për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të mbajtjes e trafikimit të lëndëve narkotike.

Të gjithë punonjësit e policisë të pyetur nga punonjësit tanë nuk pranuan që të kishin keqtrajtuar shtetasin M.Gj.. Gjithashtu ata deklaruan se nuk kishin parë që ai të keqtrajtohej as nga punonjësit e policisë të forcave speciale.

Ndërkohë theksojmë se, dy punonjës policie Gjergj Ashta dhe Bahri Laçaj pohuan se, kur e morën në dorëzim M. nga forcat speciale kanë konstatuar se ai kishte disa dëmtime në fytyrë dhe në trup. Sipas një punonjësi policie, Bahri Laçaj, kur M. e ka pyetur e ëma se kush e kishte rrahur, ai kishte

thënë se e kishin rrahur policët e forcave speciale të cilët ishin me kapuçë në kokë dhe jo policët që po e ruanin.

Deklarimet mohuese të punonjësve të policisë, se shtetasi M.Gj. nuk është dhunuar prej tyre dhe se ata nuk kanë parë që ai të jetë dhunuar as nga forcat speciale të policisë, rrëzohen nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga ana jonë. Pretendimet e ankuesit se, ai është dhunuar fizikisht nga punonjësit e policisë Avni Canameti etj., provohen nga deklaratimet e shtetasve Gj.Gj., M.Gj., Xh.Gj., M.M., M.M. dhe L.Rr., si dhe deklaratimet e punonjësve të policisë Gjergj Ashta dhe Bahri Laçaj. Gjithashtu dhunimi fizik i shtetasit M.Gj. nga punonjësit e policisë të forcave speciale të RENEA-s dhe FNSH-së dhe të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Shkodër provohet edhe nga dy fotografitë e bëra atij në banesë në kohën që ai ruhej nga dy punonjës policie, si dhe nga kartela ditore e shtetasit M.Gj. përpiluar nga ndihmësmjeku i Komisarariatit të Policisë 731 FNSH Shkodër z. Lulzim Kukaj në datën 06.07.2015. Sipas të dëmtuarit M.Gj. dhe të disa deklaruësve të tjerë, dhuna e ushtruar ndaj tij është bërë në shënjë hakmarrjeje, sepse për shkak të ngjashmërisë së tij me autorin e kërkuar, punonjësit e policisë kanë dyshuar se ai ishte autori i vrasjes së shtetasve çek.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës dhe hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe dokumentacionit të administruar nga ana jonë, arritëm në konkluzionin se ndaj shtetasit të paraburgosur M.Gj. është ushtruar dhunë fizike nga punonjësit e policisë në momentin e kontaktimit me të në oborrin e banesës së tij. Kjo sjellje e bërë ndaj tij nga punonjësit e policisë, duke e goditur me shqelma, grushta, qytë automatiku, doreza pistolete dhe bisht sopate përbën një trajtim çnjerëzor. Si pasojë e kësaj dhune, atij i janë shkaktuar dhimbje e vuajtje të rënda fizike e shpirtërore.

Sipas nesh, nga punonjësit e policisë janë konsumuar elementët e veprës penale të “Torturës”, e kryer në bashkëpunim. Dhuna e ushtruar nga punonjësit e policisë ndaj të arrestuarit M.Gj. është bërë me qëllim ndëshkimit e tij për shkak se ata kanë dyshuar se ai ishte autori i vrasjes së shtetasve çek. Shtetasit M.Gj. i është shkelur e drejta themelore e garantuar nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, *për t’iu mos u nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës.*

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës, në nenin 21/ç, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, si dhe në vijim të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga “Protokolli Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”, i cili është ratifikuar nga Kuvendi ynë me ligjin nr. 9094 datë 03.07.2003, me shkresën nr. K2/Sh34-4 Prot., datë 24.07.2015, i rekomanduam Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër *fillimin e hetimeve në ngarkim të punonjësve të policisë Avni Canameti etj, efektiv të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Shkodër dhe të forcave speciale të RENEA-s dhe FNSH-së, të cilët kanë marrë pjesë dhe kanë kryer veprime policore me të arrestuarin M.Gj., për veprën penale të “Torturës”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 86 dhe 25 të Kodit Penal, të ndryshuar.*

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër me shkresën nr. 7493/1 Prot., (Sh.M), datë 01.10.2015, na informoi se në lidhje me këtë rast, me vendimin e datës 14.09.2015 është vendosur mosfillimi i hetimit. Bashkëlidhur na dërgoi edhe kopjen e vendimit për mosfillimin e procedimit penal.

Ndërmjet të tjerave nëpërmjet këtij vendimi vihemi në dijeni se, në datën 15.07.2015, nga shtetasit Gj.Gj dhe Sh.Gj. është bërë një kallëzim penal ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër, duke i akuzuar ata se në datën 05.07.2015, rreth orës 20:30, gjatë kontrollit të banesës së tyre kanë ushtruar dhunë fizike, verbale dhe psikologjike ndaj djalit të tyre, shtetasit M.Gj..

Sipas Prokurorisë, ky kallëzim është skematik, përmban përshkrimin e disa dispozitave ligjore, por pa dhënë detaje lidhur me formën me të cilën është ushtruar dhuna, kohën kur është ushtruar ajo dhe personin konkret që ka ushtruar dhunën dhe mbi të gjitha pa dhënë asnjë shpjegim lidhur me arsyet pse ky pretendim është ngritur 10 ditë pas arrestimit të të dyshuarit.

Materialit kallëzues në fjalë i është bashkëngjitur edhe materiali (Rekomandimi) i dërguar nga Avokati i Popullit, që sipas prokurorisë, ka deklarime të hollësishme të kallëzuesve dhe personave që rezultojnë se kanë marrë pjesë në operacionin për arrestimin e të dyshuarit S.M. dhe gjatë të cilit kanë kryer edhe arrestimin në flagrancë të të dyshuarit M.Gj..

Këtij materiali i janë bashkëngjitur dy foto, njëra e shtetasit të dyshuar M.Gj., për të cilën pretendohet se është shkrepur në momentin e arrestimit, por ndërkohë nuk ka asnjë provë që vërteton kohën reale në të cilën është kryer kjo foto.

Nga këqyrja e akteve që ndodhen në fashikullin e procedimit penal nr. 1135, të vitit 2015, në ngarkim të të dyshuarit M.Gj. rezulton se, menjëherë pas referimit të veprës penale, prokurori i ngarkuar me hetimin e kësaj çështjeje penale ka marrë kontakt me të arrestuarin në dhomat e paraburgimit pranë Komisarariatit të Policisë Shkodër (dt. 07.07.2015) dhe është pyetur i arrestuari. Në deklaratimet e tij ai nuk ka ngritur asnjë pretendim për ushtrim dhune në kohën e arrestimit.

Nga kopja e fashikullit të masës së sigurimit ndaj të arrestuarit M.Gj, zhvilluar në datën 08.07.2015, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton se gjatë seancës në fjalë, as i arrestuari dhe as mbrojtësi i zgjedhur prej tij, nuk kanë ngritur asnjë pretendim se është ushtruar dhunë në momentin e arrestimit apo më vonë.

Vendimin për mosfillimin e procedimit penal për këtë rast organi i Prokurorisë e mbështet në disa konkluzione të arritura sikurse mund të përmendim:

- I dyshuari M.Gj. dhe mbrojtësi i tij, në asnjë moment, as gjatë pyetjes së tij si i arrestuar nga prokurori i çështjes në dhomat e paraburgimit në Komisarariatin e Policisë Shkodër dhe as në seancën për vlerësimin e arrestimit dhe caktimin e masës së sigurimit personal ndaj tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, nuk kanë ngritur asnjë pretendim për ushtrim dhune nga forcat e policisë në momentin e kontrollit apo arrestimit.

- Shenjat e dukshme të dhunës, që pretendon i dyshuari M.Gj, të paktën në fytyrë, nuk janë konstatuar as nga prokurori dhe as nga gjykata, pasi në të kundërt do të kishin filluar një hetim kryesisht lidhur me këtë fakt.

- Pretendimet e të dyshuarit M.Gj. si në prokurori ashtu edhe tek Avokati i Popullit, janë parashtruar 10 ditë pas datës në të cilën pretendohet se është

ushtruar kjo dhunë, duke e bërë qellimisht të pamundur verifikimin e pretendimeve të tij nga organi i akuzës.

- Fotografitë që kërkuesit i kanë bashkëlidhur kallëzimit janë bërë në mënyrë private dhe nuk kanë provueshmëri përsa i përket kohës apo vendit në të cilin janë kryer.

- Në rrethanat që shtetasi M.Gj., tek banesa e të cilit policia kishte një informacion se ishte futur i kërkuari S.M., ka refuzuar hapjen e portës dhe kjo është arritur vetëm pasi forcat speciale kanë kapërcyer murin, ushtrimi i menjëhershëm i forcës fizike për neutralizimin e personit të vetëm që kanë konstatuar në oborrin e banesës, është tërësisht legjitim, në përputhje me ligjin "Për Policinë e Shtetit", si dhe në proporcion me rëndësinë e çështjes. Po kështu edhe ushtrimi në vijim i forcës fizike për arrestimin e tij, pas konstatimit të një numri të konsiderueshëm sendesh të kundërligjshme.

- Fakti që ndaj të arrestuarit mund të jetë përdorur forcë fizike për neutralizimin e tij, shtrirja me forcë me fytyrë në dysheme dhe mbajtja ashtu deri në momentin e prangosjes, veprim i cili mund ti ketë shkaktuar lëndime të lehta, është tërësisht në përputhje me ligjin dhe në proporcion me rastin në fjalë dhe nuk përbën element të ndonjë vepre penale të parashikuara nga legjislacioni ynë penal.

Lidhur me arsyetimet dhe konkluzionet e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër në këtë vendim, të cilat i cituam më sipër, sqarojmë se:

Mosngritja para prokurorit dhe gjykatës nga shtetasi M.Gj. apo mbrojtësi i tij i pretendimeve për dhunim fizik nga punonjësit e policisë, apo bërja e kallëzimit për këtë problem nga prindërit e tij me 10 ditë vonesë nuk përbëjnë provë për ti rrëzuar ato si të pabazuara. Arsyet e kësaj vonesë mund të jenë nga më të ndryshmet, si nga pa dija e të arrestuarit dhe e prindërve të tij për të bërë ankim, nga tronditja që kanë pësuar ata nga ndodhja e kësaj ngjarjeje dhe arrestimi i M., nga motive dhe qëllime për të mosacaruar situatën me policinë, etj.

Për hirë të së vërtetës ankesa e të ëmës së tij, shetasesh Sh.Gj., pranë institucionit tonë është bërë me shkrim në datën 11.07.2015 dhe jo me 10 ditë vonesë, sikurse konkludon organi i Prokurorisë.

Mospasqyrimi i pretendimeve për ushtrim dhune të shtetasit M.Gj. apo i shenjave të dukshme të dhunës të paktën në fytyrë, si në fashikullin e procedimit penal nga prokurori i çështjes ashtu edhe në fashikullin e masës së sigurimit nga gjykata, nuk do të thotë domosdoshmërisht se ato nuk janë konstatuar nga prokurori dhe nga gjykata. Nga përvoja e deritanishme kemi konstatuar raste që, megjithëse të arrestuarit kanë qënë me shënja të dukshme dhune, nga organet e prokurorisë dhe të gjykatës nuk është vepruar për të urdhëruar fillimin e hetimit kryesisht. Sqarojmë se edhe ky qëndrim, ndonëse i kundërligjshëm, ka arsyet e veta, të cilat janë të ndryshme nga njëri rast në tjetrin. Theksojmë se, ky konkluzion e prokurorisë rrëzohet nga konstatimi i bërë nga punonjësi i institucionit tonë kur ka marrë kontakt me të paraburgosurin në IEVP Shënkoll në datën 13.07.2015 dhe nga deklaratimet e dhëna me shkrim para punonjësve të institucionit tonë nga dy punonjësit e policisë Gjergj Ashta dhe Bahri Laçaj të cilët pohuan se, *kur e morën në dorëzim Maringlenin nga forcat speciale kanë konstatuar se ai kishte disa dëmtime në fytyrë dhe në trup.*

Ndërkohë nga shqyrtimi i këtij vendimi konstatojmë se, nuk rezulton që gjatë hetimit të këtij procedimi të jenë pyetur prokurori që ka marrë kontakt me të arrestuarin apo gjyqtari që ka shqyrtuar (bërë) vlerësimin e masës së sigurimit ndaj tij. Po kështu nga organi i prokurorisë nuk janë pyetur as edhe dy punonjësit e policisë të cituar më sipër.

Gjithashtu konstatojmë se gjatë hetimit të këtij procedimi nuk janë pyetur familjarët e shtetasit M. Gj. për të sqaruar faktin se kur dhe ku i kanë bërë fotot, si dhe nuk janë pyetur as dëshmitarët, komshinjtë, e të dhunuarit të cilët kanë deklaruar kur janë pyetur me procesverbal nga punonjësit e institucionit tonë, se kanë parë momentin e dhunimit fizik të shtetasit M.Gj. nga punonjësit e policisë.

Është e nevojshme që të sqarojmë se, ashtu sikurse ka pranuar dhe pasqyruar në këtë vendim organi i prokurorisë, në rekomandimin e bërë nga institucioni ynë dhe materialet (provat shkresore) bashkëlidhur atij, të cilat ia kemi dërguar këtij organi, janë sqaruar mirë dhe në mënyrë të hollësishtme të gjitha këto pa qartësi që ka ky organ lidhur me hetimin e këtij procedimi penal.

Gjithashtu sqarojmë se, dhunimi i shtetasit M.Gj. është bërë në momentet e para, kur punonjësit e policisë kanë hyrë në oborrin e banesës së tij dhe jo pasi ata kanë ushtruar kontroll të banesës dhe të ambienteve rreth saj, ku janë gjetur edhe sendet e ndaluara, si arma dhe lënda e dyshuar si narkotike.

Nga provat e administruara nga punonjësit e institucionit tonë, nuk rezulton se ndaj shtetasit M.Gj. është ushtruar forcë në përputhje me ligjin dhe sipas parimit të proporcionalitetit, sikurse pretendon organi i prokurorisë, por ndodhemi përball faktit të ushtrimit të dhunës fizike duke e goditur atë me mjete të forta, si qytat e armëve të gjata, dorezat e pistoletave, grushta e shqelma dhe nuk bëhet fjalë për respektimin e parimit ligjor të proporcionalitetit.

Nga përmbajtja e këtij vendimi të cilin e përshkruam më sipër konstatojmë se, qëndrimi i mbajtur nga organi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër në lidhje me kallëzimin e bërë nga shtetasve Gj. dhe Sh.Gj., si dhe nga rekomandimit të bërë nga institucioni ynë, duke vendosur mosfillimin e procedimit penal lidhur me këtë rast dhe hetimin e këtij procedimi penal është i kundërligjshëm. Nga ky organ nuk janë bërë verifikime të plota, të gjithanshme dhe objektive. Ndërkohë konstatojmë se veprimet e kryera në kuadër të verifikimit të rekomandimit tonë dhe të kallëzimit penal të bërë nga shtetasit Gj.dhe Sh.Gj., janë subjektive, të njëanshme dhe dëmtojnë rëndë reputacionin dhe imazhin e organit të prokurorisë. Gjithashtu ky qëndrim shkel hapur të drejtat kushtetuese e ligjore të shtetasit M.Gj..

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, respektivisht në nenin 21/ç, të në të cilin parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale, ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara”*; si dhe në nenin 21/c të tij ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen;”*

REKOMANDOJMË:

1. Ndërhyrjen tuaj si organ epror dhe ushtrimin e kompetencave ligjore bazuar në nenin 24/5 të Kodit të Procedurës Penale, duke shfuqizuar vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, datë 14.09.2015, për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. 1786/2015.

2. Urdhërimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për fillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. 1786/2015 dhe rekomandimin e institucionit tonë dërguar këtij organi me shkresën nr. K2/Sh34-4 Prot., datë 24.07.2015. Kryerjen e hetimeve të plota, të gjithanshme dhe objektive në ngarkim të punonjësve të policisë Avni Canameti etj, efektiv të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Shkodër dhe të forcave speciale të RENEA-s dhe FNSH-së, të cilët kanë marrë pjesë dhe kanë kryer veprime policore me të arrestuarin M.Gj., për veprën penale të "Torturës", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 86 dhe 25 të Kodit Penal, të ndryshuar.

Për shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe qëndrimin që do të mbani ndaj tij, lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, konform nenit 22 të ligjit "Për Avokatin e Popullit".

Bashkëlidhur ju dërgojmë me cilësinë e provave dokumentet e më poshtme:

1. Vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, datë 14.09.2015, për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. 1786/2015.
2. Ankesa e shtetases Sh.Gj. bërë tek Institucioni i Avokatit të Popullit.
3. Procesverbali i pyetjes së shtetasit M.Gj., i mbajtur në datën 13.07.2015.
4. Procesverbali i pyetjes së shtetasit Gj.Gj., i mbajtur në datën 15.07.2015.
5. Procesverbali i pyetjes së shtetasit Xh.Gj., i mbajtur në datën 15.07.2015.
6. Procesverbali i pyetjes së shtetasit M.Gj., i mbajtur në datën 15.07.2015.
7. Procesverbali i pyetjes së shtetases M.M., i mbajtur në datën 21.07.2015.
8. Procesverbali i pyetjes së shtetases M.M., i mbajtur në datën 21.07.2015.
9. Procesverbali i pyetjes së shtetases L.Rr., i mbajtur në datën 21.07.2015.
10. Procesverbali i pyetjes së shtetasit Avni Canameti, i mbajtur në datën 15.07.2015.
11. Procesverbali i pyetjes së shtetasit Gazmend Demrozi, i mbajtur në datën 15.07.2015.
12. Procesverbali i pyetjes së shtetasit Arvit Salihi, i mbajtur në datën 15.07.2015.
13. Procesverbali i pyetjes së shtetasit Ylli Dardha, i mbajtur në datën 15.07.2015.

14. Procesverbali i pyetjes së shtetasit Gjergj Ashta, i mbajtur në datën 15.07.2015.

15. Procesverbali i pyetjes së shtetasit Bahri Laçaj, i mbajtur në datën 15.07.2015.

16. Kartela ditore e shtetasit M.Gj., përpiluar në datën 06.07.2015.

17. Dy fotografi të shtetasit M.Gj..

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI